

RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2026, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA AVOKATURA E SHETIT

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1.Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026, Avokatura e Shtetit, ka realizuar procesin e konsultimit publik për një projekt ligj, në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i cili përcakton procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare.

Avokatura e Shtetit ka miratuar një 1 (një) projektligj, objekt i konsultimit publik.

Avokatura e Shtetit, ka publikuar edhe raportin individual për rezultatet e konsultimit publik, për këtë projektligj, duke përmbushur parimin e reagueshmërisë dhe llogaridhënies së këtij procesi.

2.Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Për vitin 2026 është miratuar një projekt akt, i përgatitur nga Avokatura e Shtetit, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Gjithsej është miratuar një akt dhe është konsultuar në masën 100%.

Lidhur me këtë akt është zhvilluar konsultimi publik nëpërmjet publikimit në RENJK, duke përmbushur parakushtin për vlerësim të procesit të konsultimit publik.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Avokatura e Shtetit për periudhën Janar-Qershor 2026 ka konsultuar vetëm 1 (një) projektligj, për të cilin është kryer dhe vlerësimi i ndikimit rregullator.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Avokatura e Shtetit ka parashikuar në Programin Analitik, miratimin e 1 (një) projektvendimi për të cilin aplikohen përjashtimet e parashikuara në shkronjën “c” të nenit 4, të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e akteve të miratuara që iu nënshtruan konsultimit publik është 1 (një) projektligj.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri i konsultimeve publike të zhvilluara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është më i ulët. Kjo situatë lidhet me faktin se gjatë periudhës raportuese, Avokatura e Shtetit nuk ka pasur projektligje të planifikuara për shqyrtim dhe miratim, për të cilat të ishte e nevojshme zhvillimi i procedurave të konsultimit publik.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metoda e përdorur për konsultimin e projektligjit, ishte:

- Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar është publikuar në RENJK gjatë periudhës 19.5.2026-17.6.2026.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Nuk janë regjistruar komente në platformën RENJK.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Nuk u zhvilluan konsultime paraprake në fazën e hershme të hartimit të projektligjit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar” ka qëndruar i publikuar në RENJK, për 20 (njëzetë) ditë.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për aktet e publikuara në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJK) ka qenë 20 ditë pune.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata paraqet përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme, si në respektimin e afateve, ashtu edhe në planifikimin e procesit.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Projektligji u hartua nga Avokatura e Shtetit.

Në hartimin e projektligjit nuk morën pjesë aktorë të jashtëm jo-qeveritarë, ndërsa u angazhuan në dhënien e mendimeve Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Departamenti i Administratës Publike.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Nuk janë përfshirë anëtarë të jashtëm, në grupin e punës për ndryshimet e realizuara në projektligj.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit të projektligjit nuk ka patur palë të interesuara për dhënie komentesh ose sugjerimesh.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Nuk ka patur.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se, krahasuar me vitet e mëparshme, niveli i pjesëmarrjes në proceset e konsultimit është përmirësuar. Kjo evidentohet nga rritja e numrit të shikimeve në RENJK.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nuk ka pasur komente në RENJK.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nuk ka pasur rekomandime/komente.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Ka përmirësime lidhur me treguesin sasior, është rritur shkalla e konsultimeve publike të realizuara nga Avokatura e Shtetit, duke rritur përdorimin e instrumenteve digjital dhe aksesin e grupeve të interesit dhe publikut në vendimmarrje, dhe mundësimin e paraqitjes së komenteve dhe reagimeve të tyre për aktet e publikuara për konsultim.

Në krahasim me vitet e kaluara situata ka pasur përmirësime të dukshme lidhur me mundësimin e konsultimit publik, megjithatë interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i vlerësimit të ndikimit rregullator nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Avokatura e Shtetit ka publikuar në RENJK, raportin individual të konsultimit publik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar”.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsytet?

Nuk ka raporte të pa publikuara.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Avokatura e Shtetit vlerëson se procesi i konsultimit publik për projektligjin është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, duke garantuar transparencën, aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfida dhe mundësitë për përmirësim në të ardhmen janë rritja e gjithë përfshirjes së aktorëve për nga numri dhe kategoritë në procesin e konsultimit si dhe rritja e propozimeve për përmirësim.